

PYETJE TË SHPESHTA – GRANTI I BAZUAR NË PERFORMANCË 2026

1. Kush mund të aplikojë për Grantin e Bazuar në Performancë?

Përgjigje: Të gjitha bashkitë kanë të drejtë të aplikojnë, duke respektuar afatet, dokumentacionin dhe procedurat e përcaktuara në udhëzim.

2. Cili është afati i fundit për aplikimin për Grantin e Bazuar në Performancë (GBP) 2026 dhe cila është metoda e aplikimit?

Përgjigje: Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është data 24 korrik 2026, jo më vonë se ora 16:00.

Dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet pranë AMVV-së me shkresë zyrtare dhe nëpërmjet e-mail-it (statistika.performanca@amvv.gov.al) brenda këtij afati.

Të gjitha aplikimet protokollohen nga AMVV-ja dhe duhet të shoqërohen me dokumentacionin e kërkuar, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Përbashkët nr. 1, datë 10.06.2026.

3. A mund të dorëzohen dokumente shtesë pas përfundimit të afatit të aplikimit?

Përgjigje: Jo. Pas përfundimit të afatit zyrtar të aplikimit, data 24 korrik 2026, ora 16:00, procesi i dorëzimit të aplikimeve konsiderohet i mbyllur.

Dokumentacioni shtesë apo plotësues i dorëzuar pas këtij afati nuk do të merret në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit.

4. A mund të përdoren fondet e grantit për paga ose shpërblime?

Përgjigje: Jo. Fondet nuk mund të përdoren për shpenzime personeli apo shpërblime. Ato përdoren për nevojat e bashkisë sipas rastit.

5. A mund të aplikojë një bashki nëse nuk paraqet plan për Komponentin I?

Përgjigje: Po. Vlerësimi për secilin komponent bëhet sipas kriterëve të tij dhe bashkia mund të përfitojë nga komponenti për të cilin plotëson kushtet.

6. A mund të fitojnë të gjitha bashkitë?

Përgjigje: Po, nëse përmbushin kriteret dhe treguesit e përcaktuar në udhëzim. Nuk ka një numër të paracaktuar fituesish.

7. Cilat janë gabimet më të shpeshta gjatë aplikimit?

Përgjigje:

- Dokumentacion i paplotë.
- Mungesë e dokumentacionit mbështetës.
- Mosrespektim i afateve.

8. A mund të aplikojë një bashki përsëri me të njëjtin plan vendor nëse ka përfituar financim për të gjatë raundit të parë të GBP në vitin 2025?

Përgjigje: Jo. Bashkia ka përfituar një herë financim për atë plan vendor, i cili aktualisht është në zbatim dhe është financuar bazuar në përmbushjen e kriterëve dhe për periudhën referuese të vitit të mëparshëm. Gjithashtu, në **Aneksin 2** të Udhëzimit të Përbashkët nr. 1, datë 10.06.2026, përcaktohet qartë dokumentacioni që bashkia duhet të paraqesë për planet vendore me periudhë referuese **17 shtator 2025 – 24 korrik 2026**, ndaj nuk mund të riaplikojë me të njëjtin plan vendor gjatë kohës që ai është ende në zbatim.

9. Duke qenë se edhe për GBP 2026 treguesit për planet vendore mbeten të njëjtë me ata të një viti më parë, në cilat raste një bashki mund të aplikojë për këta tregues?

Përgjigje: Gjatë GBP 2025 kanë qenë të përfshira gjashtë plane vendore në fusha të ndryshme. Jo të gjitha bashkitë kanë arritur të hartojnë dhe miratojnë të gjashtë planet vendore, ndaj ato bashki që gjatë periudhës referuese kanë hartuar dhe miratuar plane të reja, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Udhëzimin e Përbashkët nr. 1, datë 10.06.2026, janë kandidatë për të aplikuar në kuadër të GBP 2026 për treguesin e planeve vendore. Në të kundërt disponimi I këtyre planeve bën të mundur realizimin për të përfituar grant nga treguesit e Komponentit II.

Rast përjashtimor përbën treguesi "**Plani i Mbarështimit të Pyjeve**". Edhe nëse një bashki është shpallur fituese në GBP 2025 për këtë plan, ajo mund të aplikojë sërish në GBP 2026, **vetëm në rast se aplikimi lidhet me një ekonomi pyjore të re**, për të cilën është hartuar dhe miratuar një plan i ri mbarështimi, në përputhje me kërkesat e udhëzimit.

10. Nëse një dokument mungon, a refuzohet automatikisht aplikimi?

Përgjigje: Vlerësimi bëhet sipas kërkesave të udhëzimit dhe dokumentacionit të kërkuar. Dokumentacioni i paplotë mund të ndikojë në rezultatin e vlerësimit.

11. Si bëhet ndarja e fondeve dhe si llogaritet shuma që përfiton një bashki?

Përgjigje: Fondi ndahet sipas peshës së secilit tregues dhe në përpjesëtim me performancën e bashkive që shpallen fituese për atë tregues. Duke aplikuar peshën përkatëse të secilit tregues ndaj fondit të komponentit dhe sipas metodologjisë së përcaktuar në udhëzim.

Tregues GBP-je 2026	Pesha në %	Fondi në lekë
Komponenti I – Planet vendore	100%	95,000,000
Plani Vendor i Mbarështimit të Pyjeve	30 %	28,500,000
Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	20 %	19,000,000
Plani Vendor Social	15 %	14,250,000
Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	15 %	14,250,000
Plani Vendor i Integritetit	10 %	9,500,000
Plani Vendor i Barazisë Gjinore	10 %	9,500,000
Tregues GBP-je 2026	Pesha në %	Fondi në lekë
Komponenti II – Tregues të Matshëm Rezultati	100%	155,000,000
Shkalla e regjistrimit në kopshtet publike është jo më e vogël se 60% për vitin 2025.	10%	15,500,000
% e riciklimit të të ardhurave nga ekonomia pyjore të realizuara me planifikimin/fakt në	10%	15,500,000

këtë sektor është jo më e vogël se 70% për vitin 2025.		
Gjatë vitit 2025 bashkia ka mbuluar të paktën 50% të kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga tarifa (raporti tarifa e mbledhur/kosto e shpenzuar).	10%	15,500,000
Deri në 30 qershor 2026, bashkitë e vogla do të shtojnë 1 shërbim social, bashkitë e mesme 2 shërbime sociale dhe bashkitë e mëdha 3 shërbime sociale.	10%	15,500,000
Paketa e emergjencës për viktimat e dhunës është planifikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2026.	10%	15,500,000
Bashkia ka zbatuar gjatë vitit 2025 të paktën 50% të masave të parashikuara në Planin Vendor të Integritetit për vitin 2025.	10%	15,500,000
Bashkia ka raportuar të dhënat përkatëse për të gjithë treguesit e Raportit Kombëtar të Performancës 2025 brenda afatit të përcaktuar në udhëzim.	10%	15,500,000
Niveli i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në periudhën e vlerësimit kundrejt periudhës referuese është mbi 30%. Bashkitë të cilat nuk kanë detyrime të prapambetura në periudhën referuese vlerësohen me pikët maksimale për këtë tregues.	10%	15,500,000
Realizimi i buxhetit për periudhën referuese kundrejt planit vjetor të buxhetit është në nivelin mbi 35%.	10%	15,500,000
Bashkia ka rritur nivelin e të ardhurave të realizuara nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme me të paktën 20% në 6-mujorin e parë të 2026-ës ndaj të njëjtës periudhë të 2025-ës.	10%	15,500,000